



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada – Government**  
**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /**  
**Ministry of Culture, Youth and Sport**  
Kabineti i Ministres  
Kabinet Ministra  
Minister's Office

Nr. 178/2023  
Datë: 18.10.2023

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr.08/L -117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në mbështetje të neneve 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L - 113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, si dhe në nenin 7 (paragrafi 4) të Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Planit i Menaxhimit për Parkun Arkeologjik Ulpiana.
2. Aprovimi i Planit të Menaxhimit për Parkun Arkeologjik Ulpiana, si në pikën një (1) të këtij Vendimi, shtrihet brenda kornizave të përgjegjësisive, fushëveprimit, detyrave dhe mandatit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përkatësisht njësive të saj organizative si dhe institucioneve të saj vartëse, të nivelit qendror dhe apo rajonal.
3. Obligohen njësitë organizative dhe institucionet vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të zbatojnë të gjitha obligimet e identifikuara/përcaktuara për këto njësi dhe apo institucione në kuadër të strukturës së përgjithshme të Planit të Menaxhimit Parkun Arkeologjik Ulpiana, pas aprovimit të Planit, përkatësisht pjesës së obligimeve që kanë rezultuar të jenë brenda fushëveprimit dhe kompetencave të institucioneve tjera publike të nivelit qendror dhe lokal nga këto të fundit.
4. Planit i Menaxhimit për Parkun Arkeologjik Ulpiana, konsiderohet shtojcë e këtij Vendimi.
5. Ky vendim hynë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij.

## ARSYETIM

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke u mbështetur në mandatin e saj për hartimin e politikave publike, legjislacionit dhe standardeve të detyrueshme për mbrojtjen, ruajtjen, përkrahjen dhe nxitjen e promovimit të trashëgimisë kulturore dhe historike si dhe për zbatimin dhe apo mbikqyrjen e zbatimit të këtyre instrumenteve të politikave publike dhe legjislacionit duke përfshirë edhe të planeve të veprimeve, ka inicuar emërimin e grupit punues ndërinstytucional dhe ndërsektorial për hartimin e Planit të Menaxhimit për Parkun Arkeologjik Ulpiana. Pas përfundimit të procedurave të hartimit, konsolidimit dhe konsultimit ndërinstytucional dhe publik, Plani i Menaxhimit është proceduar për aprovim nga grupi punues.

Në zbatim të përgjegjësisë dhe mandatit të tij, Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

*Vendimi i dërgohet:*

- *Kabinetit të Ministrit;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Komunës së Graçanicës;*
- *Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;*
- *Të gjitha institucioneve vartëse të Trashëgimisë Kulturore;*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Arkivit të MKRS-së.*

